



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.2.2025

Nr: 182

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE PARTIA “LIDHJA PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE SHQIPTARË”, ME KRYETAR Z. MARJUS MALAJ, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 25.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1208 Prot., datë 21.02.2025, me:

**Kërkues:** Partia politike Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me kryetar Z. Marjus Malaj.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

**Baza ligjore:** Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, nëpërmjet Kryetarit Z. Marjus Malaj ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 15.01.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me iniale “LDPSH”, me Kryetar Z. Marjus Malaj, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.

Data: 25.2.2025 Nr: 182  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me Kryetar Z. Marjus Malaj, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02)
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03)

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me shkronja nistore “LDPSH”, me adresë: Rruga "Maliq Muço", Pll. 46, Shk. 1, Ap. 1, Nj. nr. 9, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Marjus Malaj, me adresë: Rruga "Halil Aga", Nd. 8, H. 1, Nj.nr. 11, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Altena Shehu, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollësja", Banesë private nr. 120, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ilir Xhemalaj, me adresë: Rruga "Panorama", Nd. 10, H. 25, Ap. 21, Nj. nr. 9, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

#### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me kryetar Z. Marjus Malaj, me shkronjat nistore “LDPSH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**